

1 E mërkurë, 16 korrik 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
8 nderuar Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal, vërej që të katër të akuzuarit janë të pranishëm
13 në sallën e gjyqit sot.

14 Përpara se sa të fillojmë, përpara sesa të sjellim
15 dëshmitarët në sallë dhe do të fillojmë me paraqitjen e
16 provave të Mbrojtësit të Viktimave, Trupi Gjykses së pari do
17 të japë një vendim sipas rregullës 130(2) dhe (3) të
18 Rregullores së Procedurës dhe Provave, sikurse është informuar
19 në parashtrimin F03329, të nxjerrë më 11 korrik 2025.

20 Përmes vendimeve të 15 shkurtit 2023 dhe 1 tetorit 2024,
21 Trupi Gjykses ka urdhëruar ZPS-në të përfundojë paraqitjen e
22 provave të veta deri më 15 prill 2025. Më 27 mars 2025, ZPS-ja
23 paraqiti dëshmitarin e fundit të saj *viva voce*. Më 15 prill
24 2025, duke mos pasur më dëshmitarë për të thërritur, apo
25 material tjetër provues dhe shkresor për të paraqitur si pjesë

1 e çështjes së vet, ZPS-ja mbylli provat e veta. Më 12 qershor
2 2025, Mbrojtja dorëzoi një mocion të përbashkët të ekipeve të
3 Mbrojtjes sipas rregullës 130, me shtojcat konfidenciale 1 dhe
4 2. ZPS-ja iu përgjigj mocionit më 7 korrik 2025.

5 Në bazë të rregullit 130, paragrafi 3, pasi të ketë
6 dëgjuar palët dhe nëse është e zbatueshme, Mbrojtësin e
7 Viktimave, nëpërmjet një vendimi që e shqipton gojarisht,
8 Trupi Gjykses mund të rrëzojë disa ose të gjitha akuzat e
9 aktakuzës në qoftë se nuk ekzistojnë provat në mbështetje të
10 një vendimi fajësie jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me
11 akuzat në fjalë. Aftësia e provave të Prokurorisë, në qoftë se
12 pranohen, për të mbështetur një vendim fajësie përtej dyshimit
13 të arsyeshëm, bëhet nga një gjykses i arsyeshëm fakti, dhe ky
14 është një koncept kryesor. Në këtë mënyrë, testi nuk ka të
15 bëjë në qoftë se -- me faktin në qoftë se gjykses i arsyeshëm
16 do të mbërrijë në vendim fajësie përtej dyshimit të arsyeshëm,
17 sa i takon provave të Prokurorisë, në qoftë se pranohet, por
18 në qoftë se mund ta bëjë një gjë të tillë.

19 Në fund të provave të Prokurorisë, Trupi Gjykses mund të
20 konstatojë që provat e Prokurorisë janë të mjaftueshme për të
21 mbështetur një vendim fajësie përtej dyshimit të arsyeshëm.
22 Dhe pavarësisht kësaj, edhe në qoftë se ekipet e Mbrojtjes
23 vendosim që të mos paraqesin prova, Trupi Gjykses mund të
24 vijojë me vendim pafajësie në fund të gjykimit në qoftë se
25 sipas pikëpamjes së vet Prokuroria në fakt nuk ka provuar

1 fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm.

2 Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë nxjerrë
3 jurisprudencë të vazhdueshme dhe kanë qenë zakonisht në një
4 pozicion të tillë ku, kur Trupi Gjykues është, ka marrë një
5 mocion sa i takon rregullës 130, në këto raste për këtë nuk
6 është e nevojshme që të hetonte në mjaftueshmërinë e provave
7 sa i takon secilit prej paragrafëve të aktakuzës, por që
8 provat në fakt janë shqyrtuar në lidhje me secilën prej pikave
9 të aktakuzës.

10 Dhe në rastin në fjalë, Mbrojtja në fakt kundërshton
11 vetëm një prej aspekteve kryesore të paraqitjes së provave të
12 ZPS-së dhe i ka kërkuar Trupit Gjykues që të rrëzojë atë çfarë
13 ajo e përshkruan si akuza vetëm në lidhje me pyetjen e dy
14 periudhave kohore që Mbrojtja thotë që bie përtej ose shkon
15 përtej fushëveprimit të konfliktit të armatosur të pretenduar
16 nga ZPS-ja.

17 Qëndrimi i ZPS-së është se në Kosovë ka ekzistuar një
18 konflikt i armatosur jondërkombëtar që prej të paktën marsit
19 të 1999 deri në shtator të 1999. Mbrojtja ndërkohë parashtroi
20 që Prokuroria nuk ka vërtetuar që ka ekzistuar një konflikt i
21 armatosur në Kosovë përpara fundit të majit të 1998, dhe pas
22 20 qershorit 1999. Rrjedhimisht Mbrojtja i kërkon Trupit
23 Gjykues që të rrëzojë akuzat në aktakuzë që lidhen me krimet e
24 luftës që pretendohen të jenë kryer përpara fundit të majit të
25 1998 dhe pas 20 qershorit të 1999. Incidentet në fjalë

1 renditen në mocionin e Mbrojtjes në shtojcën 1 të tij.

2 Në mocionin e vet, Mbrojtja bën parashtrime të gjata
3 lidhur me atë që ajo mendon që është autoriteti i Trupit
4 Gjykues sipas rregullës 130, që të rrëzojë jo vetëm pika në
5 tërësinë e tyre, por gjithashtu edhe pjesë dhe elementë të
6 pikave të aktakuzave dhe mbështetet ndër të tjera në
7 interpretimet e mëparshme të rregullës 90(2) dhe (3) nga
8 Gjykatësit e procedurës paraprake të kësaj Gjykate. Mbrojtja
9 parashtron më tej që Trupi Gjykues do të kishte autoritetin
10 sipas rregullës 130, që të rrëzojë krimet e luftës të
11 pretenduara që thuhet që janë kryer jashtë periudhës së kohës
12 që pretendohet që të ketë pasur një konflikt të armatosur.

13 Prokuroria kundërshton parashtrimet e Mbrojtjes dhe
14 parashtron që sipas rregullës 130 duhet të bëhet një vlerësim
15 pikë pas pike i provave, dhe po ashtu në krahasim me rregullën
16 përkatëse me jurisprudencën e kësaj gjykate, por gjithashtu
17 edhe me paragrafin, me rregullën 163(4).

18 Si çështje paraprake, Trupi Gjykues vëren se as ligji dhe
19 as rregullorja nuk përmendin nocionin e "pikave", por përdorin
20 nocionin e "akuzave", megjithëse ZPS-ja ka përdorur shprehjen
21 "pika", në tekstin e aktakuzës. Trupi Gjykues më tej vëren se
22 rregulla 130 i lejon Mbrojtjes që të kërkojë që Trupi Gjykues
23 të urdhërojë rrëzimin e çdo disa ose të gjitha akuzave në
24 aktakuzë, ku përmbushet pragu përkatës.

25 Sa i takon thelbit të kundërshtimit të Mbrojtjes, Trupi

1 Gjykues vëren se incidentet dhe akuzat që kanë ndodhur në
2 kohën që kundërshtohet prej Mbrojtjes nuk janë akuza brenda
3 kuptimit të rregullës 130. Në fakt, ato janë fakte materiale
4 që kanë të bëjnë me akuzat dhe pikat në aktakuzë. Ajo çfarë
5 kundërshton Mbrojtja si rezultat nuk është një akuzë, por
6 është një pjesë e një akuze në formën e fakteve materiale të
7 caktuara që përbëjnë akuzat apo pikat në aktakuzë.

8 Mbrojtja parashtroi se ka autoritet lidhur me
9 interpretimin dhe pikat sipas jurisprudencës së TPNJ-së ku
10 sipas Mbrojtjes "akuzat" të para në raport me të gjitha
11 "pikat" e aktakuzës janë rrëzuar nga Trupi Gjykses.
12 Megjithatë, dëshiroj që të theksoj që këto janë vendime të
13 cilat janë mbështetur në versionin e vjetër të rregullës 98
14 *bis*, të rregullores së TPNJ-së, që është ndryshuar në dhjetor
15 të 2004. Që prej atëherë ndryshimet parashikojnë që "pikat" do
16 përdoren në vend të "akuzave". Trupi Gjykses konstaton që këto
17 çështje nuk mbështesin kundërshtimin e Mbrojtjes. Po ashtu,
18 Trupi Gjykses nuk ka gjetur asnjë dokument tjetër autoritativ
19 që do të mbështeste një qasje dhe një kuptim të tillë.

20 Në qoftë se do të pranohej, interpretimi i Mbrojtjes do
21 të çonte në fragmentarizimin e çështjes dhe do i kërkonte
22 Trupit Gjykses që të vendoste për secilën prej pikave
23 përkatëse, ose fakteve materiale, të kundërshtuara nga
24 Mbrojtja, pavarësisht në qoftë se kundërshtimi është për shkak
25 të kohës, gjeografisë, apo thelbit. Megjithatë, sikurse

1 vërehet dhe sikurse është përshkruar dhe më sipër, rregulla
2 130 është synuar dhe është interpretuar në mënyrë të
3 vazhdueshme se kërkon një rishikim të provave që kanë të bëjnë
4 me secilën prej pikave të aktakuzës, dhe jo dhe çdo fakt
5 material apo pretendime materiale që përbëjnë akuzat apo pikat
6 në aktakuzë. Trupi Gjykses vëren se një interpretim i ngjashëm
7 dhe një kuptim i tillë zbatohet në lidhje me rregullën 163,
8 paragrafi 4, që parashikon mbështetje të mëtejshme për
9 interpretimin nga Trupi Gjykses të kriterëve të rregullës 130.
10 Trupi Gjykses i referohet në këtë aspekt aktgjykimit në
11 çështjen Gucati dhe Haradinaj, në veçanti paragrafëve 981 dhe
12 1006 të këtij aktgjykimi.

13 Trupi Gjykses gjithashtu vëren se secila dhe të gjitha
14 incidentet përkatëse që gjithashtu janë akuza në kuadrin e
15 krimeve kundër njerëzimit, të cilat ndryshe nga krimet e
16 luftës janë, nuk marrin parasysh dhe nuk e kanë të rëndësishme
17 ekzistencën e një konflikti të armatosur në kohën përkatëse.
18 Për rrjedhojë, edhe në qoftë se do të konsideronte në
19 themelësi dhe në qoftë se këto kundërshtime të Mbrojtjes do të
20 vlerësoheshin të suksesshme, mocioni i Mbrojtjes nuk do të
21 çonte në rrëzimin e asnjë prej pikave të aktakuzës. Ndërkohë
22 që aspektet e shpejtësisë së procesit gjyqësor janë të
23 rëndësishme në këtë fazë procesi, ato në vetvete nuk krijojnë
24 një bazë ligjore të pavarur mbi bazën e të cilës Trupi Gjykses
25 mund të shkojë përtej formulimit të qartë të rregullores.

1 Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses nuk është bindur që
2 ai ka autoritet sipas rregullës 130 për të rrëzuar pjesë të
3 akuzave ose të fakteve materiale që formojnë pjesë të
4 aktakuzës në qoftë se, për shkaqe kohe ose për shkaqe të
5 tjera. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses rrëzon mocionin e
6 Mbrojtjes sipas rregullës 130 në tërësinë e vet. Duke marrë
7 parasysh sa më lart, Trupi Gjykses nuk është e nevojshme që të
8 shkojë në themelësinë e argumenteve të Mbrojtjes sa i takon
9 periudhës së fillimit dhe të përfundimit të konfliktit të
10 armatosur jokombëtar. Pyetja, ose çështja e fushëveprimit
11 kohor ose shtrirjes kohore të konfliktit të armatosur që ka të
12 bëjë me këtë çështje gjyqësore, do të trajtohet në fund të
13 gjykimit kur të vendoset për themelësinë e çështjes.

14 Ky është fundi i vendimit të Trupit Gjykses.

15 Tani, së dyti, Trupi Gjykses do të lëshojë një urdhër
16 gojor lidhur me parashtrimin me vonesë të listës së provave
17 materiale të ZPS-së për faqet e përzgjedhura të dokumentit
18 SPOE00325698 deri në 00325769 të dorëzuara nga ZPS-ja përmes
19 Dëshmitarit 04826, dhe të pranuar nga Trupi Gjykses përmes
20 vendimit F03201/COR.

21 Në veçanti, Trupi Gjykses vëren se në vendimin
22 F03201/COR, ka pranuar faqe të caktuar të dokumentit
23 SPOE00325698 deri në 00325769, të cilat si rezultat i vendimit
24 F03211 aktualisht nuk janë pjesë e provave materiale të ZPS-
25 së. Këto faqe janë SPOE00325704 deri në SPOE0032521,

1 SPOE00325737 deri SPOE0032538, SPOE00325746 deri në
2 SPOE00325552, SPOE325755 deri në SPOE0032556, dhe SPOE0032579
3 deri në SPOE0032564.

4 Pasi ka konstatuar në vendimin F03201/COR që këto faqe
5 janë të pranueshme për aq kohë sa ato lidhen dhe janë të
6 pasqyruara në raportin e Dëshmitarit ekspert 04826, ose janë
7 të lidhura me dokumentet që përmenden në të, dhe duke
8 konsideruar që kërkesa për shtimin e tyre në listën e provave
9 materiale është më herët në datë sesa ofrimit të këtyre
10 dokumenteve për pranim përmes Dëshmitarit 04826, Trupi Gjykses
11 bindet se ZPS-ja ka demonstruar njoftim në kohë dhe ka pasur
12 shkaqe bindëse në pajtim me rregullën 118(2) për shtimin me
13 vonesë të këtyre faqeve në listën e provave materiale.

14 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses autorizon ZPS-në që të
15 ndryshojë listën e provave materiale të saj për të përfshirë
16 gjithashtu edhe faqet e mëposhtme, SPOE00325698 deri në
17 00325769 të pranuar në pajtim me vendimin F03201/COR me ERN
18 që i përmenda përpara një momenti, dhe urdhëron ZPS-në që të
19 dorëzojë një listë të përditësuar të provave materiale deri të
20 premtën 18 korrik 2025.

21 Këtu përfundon urdhri i dytë gojor.

22 Trupi Gjykses informoi palët dhe pjesëmarrësit të kenë
23 mundësinë të bëjnë parashtime të shkurtra me gojë sa i takon
24 kërkesës së përbashkët të Mbrojtjes për përjashtim të provave,
25 që është parashtimi F03328. A ka parashtime nga palët lidhur

1 me kërkesën e Mbrojtjes?

2 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Nuk e
3 di në qoftë se doni të na e jepni ne fjalën së pari ose
4 Mbrojtësit të Viktimave.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
6 ndjesë. Mbrojtësi i Viktimave i pari, më pas mund të vazhdoni
7 juve. Do të doja t'ju thoja që mos t'i zgjasni më shumë se sa
8 pesë minuta komentet tuaja.

9 Z. Laws, ju kërkoj ndjesë që ju harrova.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Pa problem, i nderuar Gjykatës.
11 Ndërkohë Gjykata e Apelit e ka zgjidhur këtë çështje të hënën
12 përmes vendimit për çështjen, aktgjykimin për çështjen Shala,
13 kështu që në qoftë se më lejoni do t'i referohem versionit
14 konfidencial të aktgjyimit të Apelit dhe më pas do kalojmë
15 përsëri në seancë publike. Kështu që për momentin do ju kërkoj
16 të kalojmë në seancë private.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, na
18 kaloni në seancë private, znj. Sekretare.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
6 jemi në seancë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
8 vazhdoni, z. Dixon.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
10 Kërkesa jonë për përjashtimin e disa pjesëve të akt-
11 ekspertizës, domethënë, dhe një herë dua ta sqaroj pozicionin
12 tonë. Po flasim për pjesë të caktuara që duhen përjashtuar,
13 sipas mendimit tonë. Pra, ne parashtrojmë që duhet që të
14 përjashtohen ato pjesë që kanë të bëjnë me besueshmërinë e
15 dëshmitarit në fjalë. Ne e kemi shumë të thjeshtë qëndrimin
16 tonë. Sipas nesh, Mbrojtësi i Viktimave nuk mund të paraqesë
17 prova përmes një dëshmitari lidhur me besueshmërinë. Këtë mund
18 ta bëjë ZPS-ja, mund ta bëjmë ne, por jo Mbrojtësi i
19 Viktimave, sepse roli i Mbrojtësit të Viktimave është i
20 kufizuar vetëm tek dëmtimi dhe pasoja. Pra, edhe një herë doja
21 ta bëja të qartë që ne kërkojmë përjashtimin e provave vetëm
22 të pjesëve të caktuara që i kemi dhënë në poshtëshënimin 2. E
23 kemi bërë shumë të qartë në mocionin tonë. Vetëm për këto
24 pjesë ne kërkojmë që të përjashtohen këto prova dhe sipas nesh
25 ato pjesë kanë të bëjnë me besueshmërinë e dëshmitarëve. Ky

1 është një parashtrim i cili mbështetet në një vendim që ju e
2 keni dhënë vetëm përpara një jave. Ka pasur një material të
3 ngjashëm dhe që ju si Trup Gjykues vendosët që materiali që
4 kërkoi Mbrojtësi i Viktimave që të pranohej të mos pranohej
5 për shkak të besueshmërisë.

6 Sa i takon aktgjykimit të Apelit, paragrafi 55, paragrafi
7 55 nuk merret fare me këtë çështje. Kjo është një çështje e
8 cila nuk është trajtuar fare në atë çështje, kështu që nuk ka
9 lidhje ndërmjet këtij paragrafi dhe asaj që parashtrojmë ne në
10 kërkesën tonë.

11 Megjithatë, ne themi dhe një herë që ajo çfarë ka bërë
12 Paneli i Apelit është që është trajtuar me pikat e apelit dhe
13 është marrë me besueshmërinë sipas pikave të apelit të
14 ngritura nga Mbrojtja, por ndërkohë nuk lidhet me këtë temë të
15 diskutimit tonë. Domethënë, paragrafi 55 nuk lidhet, pra nuk
16 është i njësisishëm me shqetësimin tonë. Ndërkohë që çështja e
17 dytë ka të bëjë me temën, temë e cila është e përgjithshme dhe
18 ku duam që të trajtojmë pikat e apelit.

19 Megjithatë, ne e parashtrojmë dhe një herë që ne nuk e
20 kundërshtojmë këtë, domethënë, neve parashtrojmë që Paneli i
21 Apelit nuk e ka vendosur, nuk ka marrë vendim lidhur me këtë
22 çështje. Mendojmë, dhe do ju luteshim që ju të shikonit
23 jurisprudencën tuaj, vendimet e tjera të nxjerra prej jush,
24 anëtarë të Trupit Gjykues, lidhur me këtë temë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Ka komente të tjera nga ekipet e Mbrojtjes?

2 Z. LAWS: [Përkthim] A mund të ndërhyj, të them unë diçka?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, patjetër.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Me gjithë respektin për z. Dixon,
5 paragrafi 55 në fakt trajton ekzaktësisht atë që z. Dixon
6 thotë që nuk trajton. Paragrafi 55 trajton konkretisht në
7 mënyrë shumë specifike besueshmërinë. Pra, ky është një
8 paragraf i cili u referohet dëshmitarëve me status të
9 dyfishtë. Dhe kjo jepet shprehimisht në këtë paragraf. Kështu
10 që ne nuk pajtohemi me qëndrimin e z. Dixon. Dhe ky është një
11 vendim i cili ka të bëjë me dëshmitarë të së njëjtës natyre.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
13 z. Laws. Do bëjmë një pushim të shkurtër në mënyrë që të
14 kuvendojmë lidhur me këtë aspekt. Do bëjmë një pushim të
15 shkurtër dhe pastaj do marrim një vendim gojor lidhur me këtë
16 temë. Më pas do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit VE-01
17 dhe 02.

18 Atëherë, do bëjmë disa minuta pushim. Do ju kërkoja të
19 mos shkonit shumë larg.

20 --- Pauza fillon në orën 9.54

21 --- Seanca rifillon në orën 09.54

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [PËRKTHIM] Trupi Gjykses
23 do të japë urdhër me gojë sa i takon për përjashtim të provave
24 nga ana e Mbrojtjes, e cila ka qenë në parashtrimin F03328.

25 Më 3 korrik 2025, Trupi Gjykses nxori urdhër, vendim

1 lidhur me kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për të pranuar si
2 prova parashtrimin e protokolluar F03305.

3 Në vendim Trupi Gjykses konstatoi se znj. Duhne-Prinsen
4 dhe Dr. Black kualifikoheshin si ekspertë sipas kuptimit të
5 rregullës 149 dhe në të njëjtën kohë, e shtyu vendimin e tri
6 akt-ekspertizave të IMMO-s që ishin përgatitur për këtë
7 çështje, Çështja 04 dhe Çështja 05 derisa të përfundonte
8 dëshmia e znj. Duhne-Prinsen dhe Dr. Black.

9 Më 11 korrik 2025, Mbrojtja bëri kërkesë të përbashkët
10 për përjashtimin e provave lidhur me disa pjesë të akt-
11 ekspertizës së IMMO-s që ishte përgatitur për gjykimin në
12 Çështjen 04 që kishte lidhje me dëshminë e një dëshmitari.
13 Mbrojtja argumenton në paragrafët 6 dhe 8 të kërkesë, se kjo
14 provë është e papranueshme sepse ka lidhje me besueshmërinë e
15 dëshmitarit, çka do të thotë, se del përtej ekspertizës së
16 Mbrojtësit të Viktimave dhe kompetencave të Mbrojtësit të
17 Viktimave.

18 Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykses të përjashtojë nga
19 Çështja 04 akt-ekspertizat e IMMO-s pjesë të caktuara të
20 raportit sidomos për pjesët që i lidhin me dëshminë e
21 dëshmitarit në procesin e mëparshëm dhe, të urdhërojë që asnjë
22 palë të mos nxjerrë prova lidhur me pjesët përkatëse të akt-
23 ekspertizës së IMMO-s që ishte nxjerrë për Çështjen 04 dhe,
24 gjithashtu, të nxjerrë urdhër për afate të përshpejtuara
25 lidhur me këtë kërkesë ose t'i japë mundësi Mbrojtjes të bëjë

1 argumente me gojë përpara se të fillojnë dëshminë dëshmitaret
2 znj. Prinsen dhe Dr. Black.

3 Mbrojtësi i Viktimave parashtroi, siç është konfirmuar
4 dhe nga Paneli i Gjykatës së Apelit në Çështjen 04, Mbrojtësi
5 i Viktimave ka interes dhe ka kompetencë të trajtojë dhe
6 aspekte lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit.
7 ZPS-ja parashtroi si pjesë të caktuar të raportit që
8 kundërshton Mbrojtja, në fakt, lidhen me dëmin që kanë pasur
9 këto viktimat. ZPS-ja shton se ekspertët e kanë kryer
10 vlerësimin e tyre mjeko-ligjor dhe kanë konstatuar disa
11 simptoma dhe pasoja që janë relevante dhe Mbrojtësi i
12 Viktimave ka të drejtë të nxjerrë dëshmi lidhur me këtë.

13 Mbrojtësi i z. Kadri Veseli parashtroi që Mbrojtësi i
14 Viktimave nuk mund të paraqesë prova përmes një eksperti sa i
15 takon besueshmërisë. Sipas avokatit të z. Veseli është roli i
16 Mbrojtjes ky apo i ZPS-së po nuk ka të drejtë Mbrojtësi i
17 Viktimave sepse roli i Mbrojtësi i Viktimave të ka vetëm
18 lidhje me dëmin dhe me pasojat që kanë pasur viktimat.

19 Pasi dëgjua nga palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykues
20 konstaton se pjesë të caktuara të raportit të iMMO-s në
21 Çështjen 04 nuk lidhen vetëm me besueshmërinë e dëshmitarit
22 dhe nuk janë jashtë ekspertizës së autorëve të raportit. Trupi
23 Gjykues vëren se znj. Duhne-Prinsen që ka qenë bashkautore e
24 raportit në fakt është eksperte e vlerësimit të çrregullimit
25 të stresit post-traumatik dhe ka të drejtë të vlerësojë

1 sjelljen e një dëshmitari në procese penale. Akt-ekspertiza e
2 iMMO-s, në fakt, është pikërisht ekspertiza e saj. Trupi
3 Gjykues konstaton në tej se thjesht po përpiqet, Mbrojtësi i
4 Viktimave thjesht po përpiqet të vërtetojë dëmin mendor që
5 kanë pasur viktimat në këtë proces gjyqësor.

6 Sa i takon argumenteve të Mbrojtjes, Trupi Gjykues nuk ka
7 trajtuar argumentet e Mbrojtjes që kishin lidhje me dëshminë e
8 dëshmitarit në vendimin të 3 korrikut 2025, ne konstatojmë në
9 fakt se Mbrojtja e ka keqinterpretuar vendimin tonë. Trupi
10 Gjykues qartë e ka bërë në paragrafët 29, 30, 32 dhe 45 të
11 vendimit se duke marrë parasysh kundërshtimet e Mbrojtjes në
12 bazë të rregullës 149, do të pranonte vetëm lidhur me
13 pranueshmërinë e akt-ekspertizave të iMMO-s pasi të kishin
14 përfunduar dëshminë dëshmitarët, Mbrojtja ka pasur mundësi të
15 bëjë kundërpjetje dhe Trupi Gjykues ka marrë parashtrime nga
16 Mbrojtësi i Viktimave dhe nga palët në përfundim të dëshmisë
17 së dëshmitarëve ekspertë. Prandaj nuk ka asnjë arsye pse ta
18 ndryshojmë këtë vendim. Çdo argument që lidhet me
19 mospranueshmërinë e pjesëve të caktuara të akt-ekspertizave në
20 proceset e mëparshme në Çështjen 04, në fakt, do të trajtohet
21 në vendimin e ardhshëm të Trupi Gjykues lidhur me
22 pranueshmërinë e akt-ekspertizave të iMMO-s dhe do t'i marrim
23 parasysh parashtrimet që janë bërë lidhur me këtë pikë. Pra,
24 kërkesa e Mbrojtjes që është me numër F03328, rrëzohet. Me kaq
25 mbyll urdhrin me gojë.

1 Do fillojmë tani me dëshminë e dëshmitareve të Mbrojtësit
2 të Viktimave me kodet VE-01, VE-02.

3 Ju lutem sillni dëshmitaret në sallë.

4 Z. PUSTAY: [Përkthim] Ju lutem, përpara se të vijnë
5 dëshmitarët. Na kanë dhënë këtë shënim përgatitor sot
6 paradite.

7 A ka ndonjë shpjegim çfarë është ky dokument dhe si do të
8 përdoret ky dokument për dëshmitaret?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kanë kërkuar
10 vetë dëshmitaret ta kishin këtë shënim në sallën e gjyqit, ne
11 thamë që mund ta sillnim shënimin, por e ndamë me palët.

12 Z. PUSTAY: [Përkthim] Kjo do të thotë që do të lexojnë
13 shënimet përgatitore?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk do ta
15 lexojmë. Por në qoftë se do kenë nevojë t'i referohen do të
16 marrin leje paraprakisht nga Trupi Gjykses dhe ne do t'ua
17 lejojmë ose do t'ua rrëzojmë kërkesën lidhur me shënimin
18 përgatitor.

19 [Dëshmitaret hyjnë në sallën e gjyqit]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, mos
21 u ulni, qëndroni në këmbë. Dhe vendosni kufjet.

22 Mirëmëngjesi, znj. Duhne-Prinsen. Po e shqiptoj mirë?

23 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Duhne, është emri
24 im.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] Dhe Dr. Catherine Nicola Black.

2 Në vendimin e 3 korrikut 2025, që ka numrin F03305, Trupi
3 Gjykues lejoi që ju të jepni dëshmi njëkohësisht, njëherazi
4 pra.

5 Përpara se të bëni betimin solemn, do t'ju jap disa
6 udhëzime ju por dhe palëve dhe pjesëmarrësve për shkak se po
7 jepni dëshmi njëherazi dua të jap disa udhëzime.

8 Pak më vonë do të bëni betimin solemn. Secila më vete.
9 Për të ndihmuar stenografin për transkriptin sa herë që
10 Mbrojtësi i Viktimave, avokati, do të bëjnë një pyetje, duhet
11 të thonë se kujt po ia bëjnë pyetjen, pra, duhet të përmendin
12 emrin se cilës prej jush po i drejtohen.

13 Edhe ju kur të flisni, ju lutem, flisni, përgjigjuni me
14 emrin tuaj fillimisht më pas jepni përgjigje. Sepse kjo do të
15 na ndihmojë ne të pasqyrojmë siç duhet në transkript se cila
16 prej eksperteve po përgjigjet.

17 Ju, në fakt, po dëshmoni bashkë, kështu që, do të bëhen
18 pyetje nga pala thirrëse, do të ketë kundërpjetje, do të ketë
19 pyetje plotësuese dhe do pasqyrohen sikurse të jetë bërë nga
20 një dëshmitare e vetme kjo.

21 Gjithashtu, do të bëni shënime në materialet që keni
22 përpara. Nëse doni të bëni shënime do t'ju ndihmojë Sekretarja
23 e seancës për këtë qëllim.

24 Sekretarja e seancës tani do t'ju japi tekstin e betimit
25 solemn që duhet ta bëni në bazë të rregullës 149(5) të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 22

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Çështje procedurale

1 Rregullores.

2 Ju lutem, merrni tekstin dhe do ju lutesha ta lexoni me
3 zë.

4 Fillojmë me betimin solemn të Dëshmitares VE-01, znj.
5 Duhne-Prinsen, ju lutem. Lexojeni ju tekstin me zë të lartë.

6 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për
7 rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore,
8 deklaroj solemnisht se do të kryej analizën si ekspert në
9 mënyrë të ndërgjegjshme dhe me aq sa di dhe se do të jap
10 përfundime dhe mendime të sakta dhe të plota.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 I lutem tani Dëshmitarit VE-02, Dr. Black, ju lutem
13 lexoni ju betimin solemn.

14 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për
15 rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore,
16 deklaroj solemnisht se do të kryej analizën si ekspert në
17 mënyrë të ndërgjegjshme dhe me aq sa di dhe se do të jap
18 përfundime dhe mendime të sakta dhe të plota.

19 DËSHMITARJA: KARIN DUHNE-PRINSEN

20 DËSHMITARJA: CATHERINE NICOLA BLACK

21 [Dëshmitaret përgjigjen përmes përkthimit]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pajtoheni me
23 betimin solemn, znj. Prinsen?

24 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, pajtohem.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dr. Black?

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 23

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Çështje procedurale

1 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po, pajtohem.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të
3 uleni të dyja.

4 Dëshmitare, dëshmia juaj mendohet se do të zgjasë
5 përafërsisht dy ditë. Sikurse e dini, fillimisht do t'ua bëjë
6 pyetjet Mbrojtësi i Viktimave. Kur të përfundojë Mbrojtësi i
7 Viktimave, kanë të drejtë t'ju bëjnë pyetje ZPS-ja edhe
8 Mbrojtja, por edhe Gjykatësit mund të kenë disa pyetje për ju.

9 Mbrojtësi i Viktimave ka parashikuar dy orë për pyetjet e
10 veta. ZPS-ja ka njoftuar se po ashtu do të ketë nevojë për
11 përafërsisht dy orë, Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar katër orë
12 për pyetjet e veta. Ju lutem palëve të jenë sa më të
13 kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës. Trupi Gjykses mund të
14 lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen kriteret përkatëse.

15 Dëshmitare, ju lutem, përgjigjuni qartë, me fjali të
16 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që
17 pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që
18 ta sqarojmë. Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku e bazoni
19 njohurinë lidhur me faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju
20 bëjnë pyetje.

21 Në qoftë se Mbrojtësi i Viktimave ju kërkon të përmendni
22 korrigjimet që i keni bërë raporteve tuaja, ju lutem, thoni
23 për procesverbal se akt-ekspertiza, bashkë me listën e
24 korrigjimeve përkatëse, pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

25 Flisni pranë mikrofonit, prisni pesë sekonda përpara se

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 24

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Çështje procedurale

1 të përgjigjeni dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

2 Gjatë kohës që do jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk
3 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
4 jashtë sallës së gjyqit. Nëse një person ju bën pyetje jashtë
5 Gjykatës lidhur me dëshminë tuaj, ju lutem, na vini në dijeni.

6 Ju lutem ndërprisni fjalën nëse ua kërkoj unë dhe
7 gjithashtu ndërprisni fjalën nëse e shihni që unë po ngre
8 dorën. Sepse kjo do të thotë që unë duhet të jap udhëzime.

9 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na njoftoni dhe
10 ne do të bëjmë organizimin përkatës.

11 Trupi Gjykues e kupton se ju keni kopje fizike të akt-
12 ekspertizave tuaja, jetëshkrimeve dhe dokumenteve të tjera që
13 do t'i përdorni si referencë gjatë dëshmisë suaj nëse do të
14 lind nevoja. Trupi Gjykues vëren, se përpara seancave, palët
15 dhe pjesëmarrësit po ashtu kanë kopje të materialeve që keni
16 përgatitur ju përpara dëshmisë suaj. Nëse nuk ju kujtohet
17 diçka dhe për rrjedhojë keni nevojë të konsultoheni me
18 dokumentet përkatëse për t'ju rifreskuar kujtesën, duhet të
19 njoftoni Trupi Gjykues paraprakisht. Po e theksoj, këtë duhet
20 ta bëni vetëm nëse duhet me doemos të lexoni dokumentin sepse
21 nuk ju kujtohet diçka. Nuk duhet të lexoni nga këto dokumente.
22 Ne do vijojmë me pyetje-përgjigje, pra, mund ta lexoni
23 dokumentin për t'ju rifreskuar kujtesën por vetëm me lejen e
24 Trupi Gjykues.

25 E kuptuat këtë? Mirë. Fillojmë me Mbrojtësin e Viktimave,

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 25

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 i cili është personi i parë që do t'ju bëjë pyetjet.

2 Mund të filloni.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

4 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

5 Z. LAWS: [Përkthim]

6 PY. Dhe mirëmëngjes të dyjave. Sikurse e dini, unë jam

7 Mbrojtësi i Viktimave në këtë lëndë gjyqësore. Unë do t'ju bëj

8 disa pyetje për paraditen e sotme.

9 Do fillojmë me kualifikimet tuaja dhe me përvojën tuaj.

10 Dhe, nëse më lejoni, do të filloj me ju, znj. Prinsen.

11 Znj. Prinsen, çfarë profesioni keni?

12 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Unë jam znj.

13 Prinsen. Profesioni im është psikologe e fushës së

14 shëndetësisë, punoj për Universitetin e Utrecht dhe immo-n,

15 Institutin Forensik të Holandës.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Ju lutem, të vendosim në ekran dy

17 dokumente përbri njëri-tjetrit. Dokumentin V0000034 deri në 35

18 nga një anë. Dhe përbri dokumentin V000005 deri në 33, ju

19 lutem.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. LAWS: [Përkthim] Patjetër.

22 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

23 këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani jemi

25 gati, z. Laws.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 26

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Z. LAWS: [Mikrofoni çaktivizuar]. [Përkthim] Në ekran
2 janë dy faqe të jetëshkrimit të znj. Prinsen. Nëse më lejoni,
3 në fakt, nëse mundeni, dua të shikoj vetëm faqen e parë të
4 jetëshkrimit. Pra, edhe njëherë dokumenti ishte -- unë thashë
5 dokumenti 000005 deri në 33, ky ishte dokumenti që kisha
6 kërkuar unë të shfaqej përbri dokumentit që doli në ekran.
7 Faleminderit.

8 PY. Znj. Prinsen, ju na thatë që profesioni juaj është
9 profesioni i psikologes. A e shihni jetëshkrimin tuaj në të
10 majtë të ekranit përpara jush?

11 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

12 PY. A thuhet këtu që keni qenë psikologe e shëndetit mendor
13 nga viti 2015 e deri më sot në vendet që shfaqen në dokument,
14 në pozicionet që shfaqen në dokument?

15 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, saktë.

16 PY. Dhe në punën tuaj keni trajtuar veçanërisht rastet e
17 viktimave të torturës dhe të trajtimit çnjerëzor, apo jo?

18 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, saktë.

19 PY. Ju thatë se punoni për një organizatë që quhet i-M-M-O,
20 institut, immo, saktë?

21 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

22 PY. Ç'domethënë immo, këto inicialet, çfarë janë në
23 holandisht dhe nëse mundeni të na i shpjegoni në anglisht më
24 pas?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Në holandisht immo

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 27

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 --

2 PËRKTHYESJA: Përkthyesi nuk e njeh holandishten.

3 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Në anglisht është

4 Instituti Holandez për Vlerësimin e të Drejtave të Njeriut.

5 Dhe ne mbrojmë të drejtat e njeriut duke bërë ekzaminime

6 mjeko-ligjore për viktimat të dyshuara të torturës dhe të

7 trajtimit çnjerëzor.

8 PY. Faleminderit. Shohim në të djathtë të ekranit.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Ju lutem, shkojmë më poshtë në faqe

10 që shohim disa shkronja shumë të vogla dhe do ju lutesha ta

11 zmadhoni pak që të kemi mundësi ta lexojmë.

12 PY. Tek poshtëshënimi, te faqja e parë e akt-ekspertizës, ju

13 keni thënë që jeni specialiste e mjekësisë ligjore për imMO-n

14 qysh prej 2025. Keni përfunduar trajnimin e imMO-s dhe merrni

15 pjesë në trajnime të vazhdueshme në këtë institucion, është e

16 saktë kjo, znj. Prinsen?

17 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, është e saktë.

18 PY. Pra, ju keni dhe diplomë për terapinë e sjelljes dhe

19 diploma në fakt është e përmendur dhe tek jetëshkrimi juaj dhe

20 thoni që e keni përfunduar studimet në Universitetin e

21 Maastricht, apo jo?

22 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, tërësisht. Jo

23 tërësisht e saktë, sepse terapia e sjelljes për sjelljen është

24 një kurs në fakt, është kurs që e bën personalisht gjatë kohës

25 që punon me pacientët dhe kjo mund të kryhet kudo, ky kurs

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 28

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 mund të kryhet kudo. Është një kurs që unë e kam bërë në vende
2 të ndryshme në fakt.

3 PY. Faleminderit. Këtu thuhet që në 2002 keni marrë diplomë
4 nga Universiteti i Maastricht për psikologjinë zhvillimore, a
5 është kjo e saktë?

6 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Saktë.

7 PY. Na ndihmoni, na jepni një ide sa persona keni
8 diagnostikuar apo trajtuar si persona me trauma, pra, keni
9 diagnostikuar dhe keni trajtuar gjatë punës suaj?

10 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Gjatë kohës që kam
11 punuar për IMMO-n, mendoj se kam kryer ekzaminime mjeko-
12 ligjore për më shumë se 60 persona dhe për të 60 rastet i kanë
13 rishikuar kolegët në të njëjtin profesion.

14 PY. Po përveç IMMO-s a keni trajtuar raste të persona që
15 vuajnë nga trauma?

16 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po. Si psikologe e
17 shëndetit mendor, përpara se të punoja për IMMO-n, unë kam
18 trajtuar rastet e personave që vuajnë nga trauma.

19 PY. Na thoni me përafërsi sa persona keni trajtuar?

20 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Besoj se është
21 shumë e vështirë t'ju jap një numër qoftë edhe të përafërt.
22 Kam punuar për dhjetë vjet në fushën e psikologjisë të
23 shëndetit mendor. Por mbase 50, 60 persona.

24 PY. A është e vërtetë se jeni bashkautore e dy akt-
25 ekspertizave që janë përgatitur për një proces tjetër gjyqësor

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 29

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 në këtë Gjykatë, pra, përkatësisht për Çështjen 04 dhe 05.

2 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Saktë.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Tani do kërkoj pranimin e
5 jetëshkrimit të znj. Prinsen, duke marrë parasysh dhe vendimin
6 tuaj me numër F02787, ne propozojmë që të marri një numër
7 provizor aktualisht.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jepini një
9 numër provizor atëherë.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.
11 Jetëshkrimi do të marrë numrin e provës V00063 dhe klasifikimi
12 është konfidencial.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky është numër
15 provizor.

16 Z. LAWS: [Përkthim]

17 PY. Tani do t'ju drejtohem znj. Black dhe do t'ju bëj pyetje
18 të ngjashme.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Por ndërkohë ju lutem të hiqni dok në
20 të majtë të ekranit dhe të vendosni dokumentin V0000036 deri
21 në V0000037.

22 PY. Znj. Black, çfarë profesioni keni?

23 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Unë jam Katherine Black.

24 Unë jam psikiatre.

25 PY. Znj. Black, a është jetëshkrimi juaj ky në ekran?

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 30

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

2 PY. A mund të shohim fillimisht faqen e parë. Shohim që këtë
3 vit, 2025 pra, jeni bërë dhe ju pjesë e IMMO-s?

4 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

5 PY. Dhe ju bëni ekzaminime, vlerësime mjeko-ligjore në
6 përputhje me Protokollin e Stambollit, saktë?

7 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

8 PY. Do flasim pak më vonë përpara këtë Protokollin e
9 Stambollit. Gjithashtu punoni për Qendrën Sinai, jeni
10 psikiatre dhe keni filluar të punoni atje qysh prej 2024,
11 kështu?

12 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Unë në fakt kam filluar të
13 punoj atje që në 2024, pra, kam filluar në 2024 si psikiatre,
14 po kam filluar fillimisht punën në 2023 në këtë organizatë.

15 PY. Faleminderit. Shohim në fund të faqes kualifikimet tua.
16 Keni diplomë dhe keni marrë titullin daktreshë e mjekësisë,
17 apo jo?

18 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

19 PY. Mund të na tregoni diçka lidhur me përvojën tuaj kur keni
20 trajtuar, si keni trajtuar personat që vuajnë nga trauma.

21 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Gjatë kohës që jam
22 përgatitur si psikiatre, jam formuar si psikiatre, unë zgjedha
23 të punoja në dy qendra të specializuara në trajtimin e rasteve
24 me trauma. Një syresh përmendet dhe në jetëshkrimin tim quhet
25 Qendra ARK, në Diemen, në Holandë. Është shumë e specializuar

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 31

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 për trajtimin e traumës. Atje kam punuar nga 2020 deri në
2 2022, kryesisht me refugjatë, shumë prej të cilëve janë
3 viktima torture. Punoja po ashtu njëkohësisht në Qendrën
4 Sinai, po jo me kohë të plotë, tani punoj me kohë të plotë
5 atje. Kjo është klinikë që pranon personat që vuajnë nga raste
6 të rënda traume. Ka pacientë të ndryshëm atje, ka persona që
7 kanë pas trauma qysh në fëmijërinë e hershme, të gjithë janë
8 refugjatë. Kam punuar pjesërisht dhe në Klinikën Sinai për
9 veteranët e luftës. Aktualisht punoj në Klinikën Sinai,
10 vazhdoj të punoj atje domethënë, ka persona të ndryshëm që
11 vuajnë nga trauma, persona që kanë qenë viktima torture apo që
12 kanë pësuar trauma qysh kur kanë qenë fëmijë dhe në këtë rast
13 të gjithë personat janë refugjatë.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Atëherë mund të kërkoj që t'i
16 vendosim një numër provizor edhe këtij jetëshkrimi?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

18 Jepini një numër provizor.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

20 Thjesht do të bëj një korrigjim për numrin e parë. Numrin
21 e parë që duhet t'i kisha dhënë jetëshkrimit është V00032. Ju
22 kërkoj ndjesë.

23 Ju lutem, mund të më jepni dhe ERN e jetëshkrimit të parë
24 sepse mesa shoh unë të dyja CV-të kanë një ERN. Mund të na
25 specifikoni atëherë çfarë numri ka secila prej tyre?

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 32

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Z. LAWS: [Përkthim] Patjetër. CV-ja e parë, faqja e parë
2 përfundon tek numri 34 dhe kalon në numrin 35, ndërsa kjo
3 është 36, 37, 38, CV-ja e dytë pra.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, sikurse ju
5 thashë CV-ja e parë me numër V0000034 dhe 35 mori numrin
6 provizor V00032, ndërsa CV-ja e dytë me ERN V0000036 deri në
7 38 do të marri numrin provizor V00033. Dhe klasifikimi është
8 konfidencial.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.
10 PY. Vazhdojmë, flasim për temën e radhës që është akt-
11 ekspertiza juaj e 29 prillit këtë vit që është përgatitur për
12 këtë gjykim, është aktualisht në të djathtë që ekranit.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Ju lutem të hiqni CV-në nga ekrani
14 dhe vendosni raportin. Faleminderit. Së pari, a përqendrohemi
15 tek faqja një, vetëm faqen një, ju lutem në ekran. Të jetë e
16 dukshme e tëra. Faleminderit. Tani shkojmë në faqen 28 të
17 raportit, ju lutem.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
19 Sekretare, a mund ta zmadhoni pak?

20 Z. LAWS: [Përkthim]

21 PY. Po ju bëj të njëjtën pyetje. Faqja e parë e raportit,
22 emri juaj, pra, Carin Duhne-Prinsen.

23 Është kjo faqja e parë e raportit tuaj, e identifikoni si
24 të tillë?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 33

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 PY. Pyetje të njëjtë.

2 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Tani a mund të shfaqim në ekran

5 dokumentin V0000338 deri në V0000339.

6 PY. Do t'ju bëj të njëjtat pyetje. A mund të konfirmoni që

7 kjo është letra me udhëzimet që keni marrë nga ekipi i

8 Mbrojtësit të Viktimave nga Dhomat e Specializuara të Kosovës

9 ku ju kërkohej që të jepnit një raport dhe të jepni pyetjet

10 ndaj të cilave do jepni përgjigjet.

11 T'ju pyes juve të parën.

12 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, është e saktë.

13 PY. Dr. Black?

14 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po, është e saktë.

15 PY. Faleminderit. Do të merremi me pyetjet pas pak. Doja të

16 jem i qartë lidhur me një pikë që ka të bëjë me kufizimet të

17 saktësuar në këtë letër udhëzimesh.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Kjo gjendet në faqen e dytë, numri

19 IV.

20 PY. Që të jemi ët qartë që nga fillimi, pra, ju konfirmoni se

21 letra përfshinte në këtë paragraf, pra dhe po lexoj:

22 "iMMO-s nuk i kërkohej nga Mbrojtësi i Viktimave që të

23 bëhej një ekzaminim mjekësor individual të viktimave.

24 Megjithatë, për rrjedhojë raporti nuk bazohet në ekzaminimin

25 mjekësor të viktimave dhe nuk pritet që iMMO të bëjë një

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 34

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 diagnozë mjekësore për secilin prej viktimave.

2 Ky është kufizimi në punën tuaj, apo jo, znj. Prinsen?

3 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, saktë.

4 PY. Dr. Black?

5 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] E saktë.

6 PY. Faleminderit shumë.

7 Z. LAWS: [Përkthim] Tani mund t'i japim një numër

8 provizor këtij dokumenti, ju lutem.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të jepni
10 një numër provizor, znj. Sekretare?

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
12 Gjykatës. Nëse Mbrojtësi i Viktimave mund të na sqarojë, ju
13 lutem, nëse bëhet fjalë për dokumentin në tërësi apo thjesht
14 pjesa nga faqja 338 deri në 339, sepse dokumenti përfundon në
15 faqen 342.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Do ta bëjmë këtë gjë, në fakt, do
17 të merremi me faqet e tjera pas pak, pra, është më mirë që ta
18 lëmë numrin provizor për më vonë. Kemi dhe disa faqe nga kjo.
19 Në rregull.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. LAWS: [Përkthim] A mund të kthehem tek raporti i
22 IMMO-s dhe në faqen ku gjenden emrat e autorëve, faqja 28 e
23 raportit. Është 000005 deri në faqen 32.

24 PY. Diçka që të qartësojmë dhe do t'ju bëja këtë pyetje.

25 Znj. Prinsen, a mund të na thoni, ju lutem, lidhur me

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 35

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 autorin, na tregoni për autorin tjetër të raportit, emri i të
2 cilit shihet aty, cili ishte roli i saj?

3 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Autori tjetër i
4 raportit, autorja është Jet Steen, që është psikologe që punon
5 për IMMO, ajo na ka ndihmuar në këtë raport akt-ekspertizë. Ka
6 ndihmuar me kërkimet e literaturës, me kodimin e dëshmimeve, ka
7 patur, pra, rol mbështetës në përpilimin e akt-ekspertizës,
8 raportit të akt-ekspertizës.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Tani mund të kalojmë në faqen 6 të
11 raportit që është në ekran, që është me numrin V0000010.

12 PY. Në faqen 6, në krye të faqes shohim pyetjen e parë që ju
13 është bërë juve. Është një version më i shkurtër, më i mangët
14 i pyetjes së plotë fillestare, i cili i referohet, ku
15 referenca është "njohurive dhe përvojave tuaja në literaturën
16 shkencore", por ju keni nxjerrë nga kjo pyetje pjesën që ishte
17 më domethënëse, më e rëndësishme, pra, pyetja është:

18 "Cilat janë pasojat tipike (apo të mundshme) psikologjike
19 (afatshkurtër dhe afatgjatë) të keqtrajtimit mbi viktimat e
20 drejtpërdrejta (po bëhet fjalë për viktimat të trajtimit
21 çnjerëzor dhe situatat e ndalimit arbitrar)?"

22 Dhe është pjesa B:

23 "Çfarë dihet për mekanizmat e adaptimit apo të mbrojtjes
24 në këto raste?"

25 Dhe, znj. Prinsen, nëse mund të na ndihmoni ju me këtë, e

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 36

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 pranoni këtë, e identifikoni si pjesa, pyetja e parë që keni
2 trajtuar në raport, mund ta konfirmoni këtë, mendoj që
3 përgjigja juaj është rreth katër faqe, deri në krye të faqes
4 11?

5 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Unë jam znj.
6 Prinsen. Kjo është e saktë që thoni. Kjo ishte pyetja. Dhe
7 mund të konfirmoj që shkon deri në faqen 11. Dua ta shoh në
8 ekran që të jem më e sigurtë.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Do ta shohim pas pak
10 këtë gjë. Më lejoni t'ju sqaroj pak sesi do veprojmë.

11 Me këtë përgjigje që ju keni dhënë në këto tre faqe është
12 e detajuar e hollësishme dhe nuk do të hyj në hollësi të saj
13 rresht pas rreshti. Gjykatësit e kanë tani atë me shkrim. Do
14 t'ju kërkoj që të na ndihmoni lidhur me disa prej përgjigjeve
15 dhe t'ju pyes për më shumë hollësi dhe sqarime, qartësime
16 lidhur me disa tema të caktuara.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Dhe do të filloj me faqen 9 të
18 raportit, që është faqja 13, duke përdorur numrat në krye të
19 faqes në anën e djathtë. Në qoftë se mund ta zmadhojmë pjesën
20 e sipërme pak, ju lutem. Faleminderit.

21 PY. Paragrafi që dëshiroj të shqyrtojmë së bashku është
22 paragraf i tretë në këtë faqe që fillon me:

23 "Shumë studime mbi shëndetin dhe funksionimin ..."

24 E shihni këtë paragraf?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 37

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 PY. Znj. Prinsen, a mund të na ndihmoni duke lexuar këtë
2 paragraf me zë të lartë, ju lutem?

3 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Paragrafi lexon:

4 "Shumë studime lidhur me shëndetin dhe funksionimin e ish
5 të burgosurve të luftës, civilëve dhe personelit ushtarak kanë
6 treguar se mbajtja në ndalim është një prej përvojave
7 njerëzore më sfiduese. Mbjtja në ndalim ndryshon nga përvojat
8 e tjera traumatike sa i takon intensitetit dhe natyrës
9 personale të dhunës, marrëdhënies me mbajtësit dhe ata që të
10 mbajnë të ndaluar dhe efekti i kombinuar i traumatizimit të
11 përsëritur dhe të zgjatur. Këto karakteristika e bëjnë
12 ndikimin e mbajtjes në ndalim, ndikimin psikologjik të
13 mbajtjes në ndalim unik krahasuar me përvojat e tjera
14 traumatike."

15 PY. Faleminderit. Pra, kjo është ajo që studimet tregojnë, që
16 mbajtja në ndalim është një prej përvojave njerëzore më
17 sfiduese, pra, më të vështira. Do doja t'ju pyes, në përvojën
18 tuaj profesionale ku keni trajtuar persona që kanë përjetuar
19 gjërat, kanë përjetuar përvojë të ngjashme, do doja t'ju pyes
20 së pari nëse kjo përputhet apo jo me kërkimet që keni bërë,
21 qëndrimin tuaj, pra, bazuar në kërkimet tuaja?

22 Dr. Black?

23 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po, kjo përputhet me
24 përvojën time klinike. Personat me të cilët kam punuar të
25 cilët kanë pësuar torturë gjatë kohës që janë mbajtur të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 38

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 ndaluar janë në mesin e atyre që kanë simptoma të rënda dhe të
2 zgjatura. Një gjë e rëndësishme që duhet të kuptojmë, siç
3 përshkruhet në raport, në lidhje me natyrën unike, pra, të
4 vetme që mbajtja në ndalim dhe, siç e përshkruam, natyrën
5 ndërpersonale e dhunës është fakti që ne e dimë se trauma e
6 shkaktuar nga një person një personi tjetër ka efekt më të
7 thellë, më të rëndë sesa, për shembull, një përvojë traumatike
8 e shkaktuar nga një katastrofë natyrore, për shembull, je
9 viktimë e një tërmeti apo stuhie të ashpër. Impakti, pra,
10 ndikimi i traumës është ndryshe në këtë rast krahasuar me
11 traumën e shkaktuar nga dhuna që ushtron një person ndaj një
12 personi tjetër.

13 PY. Faleminderit.

14 Znj. Prinsen, keni diçka që dëshironi të shtoni?

15 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, mendoj që ajo
16 që Dr. Black tha dhe që shpjegoi e konfirmoj edhe unë.

17 PY. A mund të shkojmë më poshtë tek paragrafi ku lexon:
18 "Mbajtja në ndalim mund të çojë në ..." Dhe më poshtë një, dy,
19 tre, katër, pesë, gjashtë rreshta, me fjalinë që fillon:
20 "Hulumtimet tregojnë se trajtimi i të burgosurve ..."

21 E shihni këtë pjesë?

22 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

23 PY. A mund ta lexoni këtë?

24 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] "Hulumtimet tregojnë se
25 trajtimi i të burgosurve nga stafi i burgut gjatë mbajtjes në

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 39

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 ndalim është parashikuesi më i rëndësishëm i zhvillimit dhe i
2 pranisë së vazhdueshme të stresit post-traumatik”.

3 PY. A keni bërë ndonjë koment apo konstatime apo dëshironi të
4 bëni ndonjë konstatim lidhur me këtë?

5 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Në situatën kur një person
6 mbahet në ndalim, një prej elementeve që e bën traumatizuese
7 këtë përvojë në mënyrë unike është humbja e plotë e kontrollit
8 dhe varësia e tërësishme nga stafi i burgut ose personat që të
9 mbajnë në ndalim. Kjo do të thotë që jo vetëm situata në të
10 cilën gjendet personi është traumatizuese, por personeli i
11 burgut kontrollon aftësinë ose jo që ka personi i ndaluar për
12 të përdorur mekanizma adaptues ose mbrojtjeje.

13 Shembull për këtë mund jetë në një situatë traumatizuese
14 të paktën ju keni akoma nën kontroll faktin nëse është ditë
15 apo natë kur nuk je i ndaluar. Kur je në një situatë, kur je i
16 ndaluar personeli i burgut është e mundur që ata të kufizojnë
17 të mos japin mundësi që të shohësh dritën e diellit apo një
18 instrument që tregon kohën, orën që kalonte, për rrjedhojë
19 personi i ndaluar humbet kontrollin dhe për gjërat e vogla që
20 mund të kontrollojë. Ky është një prej elementeve që
21 kontribuon në këtë.

22 PY. Faleminderit shumë.

23 Znj. Prinsen, dëshironi të shtoni diçka lidhur me këtë?

24 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, kjo është e
25 qartë. S’kam gjë për të shtuar.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 40

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Z. LAWS: [Përkthim] A mund t'i kthehemi raportit në faqen
2 7. Mbaron në faqen 11 bazuar në numrat që janë në krye të
3 faqes. Në qoftë se mund ta zmadhojmë pak më shumë këtë pjesë,
4 ju lutem, në krye? Faleminderit.

5 PY. Dua të shohim fjalinë që fillon në paragrafin e dytë:

6 "Simptomat psikologjike më të përhapura ..."

7 Do të doja që znj. Black të ndihmojë duke lexuar këtë, ju
8 lutem? Në qoftë se mund ta lexoni prej aty, pra, deri tek
9 fjalët "zemërim".

10 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] "Simptomat psikologjike më
11 të përhapura rezultojnë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor
12 përfshin kujtime që rishfaqen në mënyrë të padëshiruar apo
13 *flashbacks* të ngjarjeve traumatike, shmangia, largimi nga
14 kujtimet, rrethanave për të shmangur, pra, gjithçka që mund të
15 zgjojë përsëri këto kujtime, një gjendje agjitimi e lartë
16 (përfshirë probleme me gjumin, zemërim i shpejtë, shpërthime
17 zemërimi, probleme me përqendrimin dhe hipervigjilancë, pra
18 vigjilencë të tepërt) dhe imazhi i vetvetes i dëmtuar nga
19 vetvetja, ndryshime negative në mendime dhe ndjenja (siç janë,
20 për shembull, besimi negativ i tepruar dhe supozimet që njeri
21 ka për veten dhe botën, si dhe ndjenjat e distancës prej
22 gjërave, sfidat, vështirësia për të përjetuar emocione
23 pozitive dhe prania mbizotëruese e emocioneve negative siç
24 është frika, tmerri dhe zemërimi)".

25 PY. Faleminderit. Doja t'ju pyes nëse mund të na ndihmoni me

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 41

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 termat e këtij paragrafi. Të gjithë kemi dëgjuar për
2 rikthimet, pra, si të kujtimeve të caktuara. Të gjithë e dimë
3 që kjo është një karakteristikë e stresit post-traumatik. Do
4 të doja që të na sqaroni pak se çfarë është një *flashback* që i
5 kthehet një personi që e ka përjetuar.

6 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Pra, një *flashback* është
7 diçka që të rishfaqet, është përvojë në të cilën individi
8 rijeton përvojën traumatike duke e menduar, duke e ndjerë,
9 duke e parë dhe në disa herë edhe sjellë sikur të ishte në atë
10 situatë traumatike që po i kujtohet përsëri po i kthehet në
11 kujtesë. Këto janë, natyrisht, shkallë të ndryshme sesa e
12 rëndë është kjo. Një person i caktuar mund të ketë këtë
13 *flashback* apo kujtim të menjëhershëm pa qenë fare i
14 vetëdijsëm për këtë, është diçka që e përjeton nga brenda.
15 Ose dikush tjetër mund ta ketë dhe mund të jetë tërësisht e
16 qartë për të gjithë neve në dhomën ku jemi të pranishëm që po
17 ndodhë diçka. Pra, dikush mund ta përjetojë nga brenda, dikush
18 mund të shfaqet dhe nga jashtë. Si shembull i kësaj është
19 procesi klinik që kur dikush futet nën tavolinë, për shembull,
20 në dysheme duke përdorur duart për t'u mbrojtur nga personi që
21 po e sulmon që, pra, nuk është aty fare ai person, nuk është
22 fare i pranishëm në dhomë.

23 Pra, ka shkallë dhe frekuenca, shpeshtësia e këtyre
24 fenomeneve ndryshon.

25 Është e rëndësishme ndoshta të shtojmë që kjo mund të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 42

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 jetë përvojë që mund të jetë ritraumatizuese, pra,
2 traumatizohet përsëri.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Na sqaroni, ju lutem, sesi një person
4 mund të ritraumatizohet nga një *flashback*, një ripërjetim i
5 diçkaje?

6 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Kjo është e ndryshme. Nuk
7 është e njëjtë, nuk bëhet fjalë për të menduar apo për të
8 kujtuar një përvojë që ke përjetuar. Bëhet fjalë të përjetosh
9 atë ashtu siç ka ndodhur, pra, në të njëjtën mënyrë dhe me
10 gjithë elementët sensorë, pra, të nuhatjes, të erës, të
11 ndjenjave. Pra, njerëzit do të kenë -- vjen erën, aromën e
12 asaj që kanë përjetuar në momentin që e kanë përjetuar më
13 parë. Do të ndjejnë në disa raste dhe dhimbjen që kanë ndjerë
14 në pjesët e trupit ku kanë ndjerë dhimbjet në kohën kur
15 ngjarja ka ndodhë në të vërtetë. Pra, kjo e bën këtë fenomen
16 jashtëzakonisht stresues nga pikëpamja emocionale. Dhe nëse
17 dikush ka përjetuar një *flashback* dhe është duke dalë nga ky
18 moment shihet niveli i stresit emocional shumë i lartë, koha
19 që duhet për të dalë nga kjo, për të marrë veten nga kjo, për
20 të kujtuar që personi është në të tanishmen tani dhe jo me
21 kujtimin e asaj që po rijeton edhe një herë.

22 Nga përvoja klinike, mund të them se vetëm kohët e fundit
23 njëri prej personave që kanë folur me të në kuadër të një
24 raportit të IMMO-s i cili kishte kaluar kohë të gjatë në ndalim
25 apo pretendohet të kishte kaluar kohë të gjatë në ndalim dhe

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 43

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 ishte torturuar, ky kishte, pra, *flashbacks*, kujtime të
2 menjëhershme të rënda, të shpeshta dhe përshkruan përvojat
3 vetë sikur ndihet që është akoma në burg sepse shpeshtësia dhe
4 intensiteti i këtyre *flashbacks* është kaq i rëndë dhe i
5 pranishëm. Kjo është rasti ekstrem, pra, i këtij spektrumi, i
6 mundësive që mund të shohim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, tani
8 do të marrim pushimin e mëngjesit në orën 11.00, kështu që ta
9 dini edhe ju.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Në rregull, z. Gjykatës.
11 Faleminderit.

12 Do të lëviz diku tjetër.

13 PY. Përpara se të kaloj më tej desha që të pyes znj. Prinsen
14 në qoftë se ka diçka për të shtuar?

15 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo.

16 PY. Pajtoheni me kolegen tuaj, znj. Black, atë që tha?

17 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Pajtohem tërësisht.

18 PY. Në paragrafin që ju sapo lexuat, znj. Black, shohim
19 referencën "imazhi për vetveten i dëmtuar". Çfarë do të thotë
20 kjo, znj. Prinsen?

21 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Imazhi i vetvetes i
22 dëmtuar do të thotë që ju zotëroheni nga mendime negative për
23 vetveten që nuk janë reale dhe nuk janë të vërteta. Pra, mund
24 të jetë, për, shembull, kur mendon për vetveten si person i
25 dobët, i pavlerë.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 44

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 PY. Faleminderit. Dhe, për të përfunduar, sa i takon termave
2 në këtë paragraf, shohim që ka elementë që "kanë gjasë të
3 shkaktojnë, të ndezin, të sjellin prapë këto kujtime, t'i
4 rikthejnë" dhe do të doja të kuptoja cilat janë këto momente
5 ose gjërat që mund të kthejnë prapë këto memori.

6 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Atëherë momentet që
7 e ndezin apo e shkaktojnë përsëri, e sjellin, këto gjëra janë
8 gjërat që u merr erë, gjërat që dëgjon, gjërat që ndjen që
9 sjellin përsëri, pra, këtë *flashback* në apo një kujtesë
10 intruzive siç quhet pra, diçka që vjen e futet në kujtesë.
11 Pra, gjërat që të kujtojnë ngjarjen traumatike të torturës.
12 Për shembull, në qoftë se personi që mbante të ndaluar pinte
13 cigare shumë, atëherë era e cigares mund të sjellë në kujtesë
14 ngjarjen përsëri. Një tjetër shembull që mund të jap është një
15 prej personave që kam ekzaminuar dhe i cili konkretisht
16 thoshte që era e pisllekut i sillte ngjarjen traumatike që
17 kishte përjetuar sepse i kujtonte pisllekun që ishte në
18 dyshe-menë e qelisë ku mbahej.

19 PY. Faleminderit.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Tani në të njëjtën faqe mundet pak më
21 poshtë. Edhe pak. Faleminderit.

22 PY. Kemi titullin "Pasoja afatgjata". Në paragrafin e dytë
23 shohim një referencë që lexon:

24 "... një analizë e kohëve të fundit tregon se këto
25 simptoma mund të jenë të pranishme, të vazhdojnë të jenë të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 45

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 pranishme për vite me radhë tek viktimat e luftës".

2 Dhe kjo i referohet këtu pra, simptomave të stresit post-
3 traumatik, apo jo? Dhe pyetja që dua t'ju bëj është që a duhet
4 të jemi të habitur që 25 vjet më vonë njerëzit raportojnë apo
5 paragesin akoma, vazhdojnë simptomat e stresit post-traumatik,
6 çrregullimit nga stresi post-traumatik? Znj. Black, në qoftë
7 se mund të përgjigjeni? Pyetja e parë.

8 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Nga përvoja ime klinike,
9 nuk mund të them që kjo më habit.

10 PY. I drejtohem znj. Prinsen, në qoftë se ka diçka për të
11 shtuar?

12 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo dhe unë
13 konfirmoj këtë dhe kjo është në përputhje me atë që shihet në
14 praktikën klinike.

15 PY. Faleminderit. Dr. Black, a dëshironi të shtoni diçka?

16 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Jo.

17 PY. Faleminderit. Tema tjetër për të cilën do të kërkoj
18 ndihmën tuaj është rëndësia e drejtësisë dhe e njohjes së
19 personave si viktimë, do të na marrë pak më shumë kohë kjo
20 temë.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Ndoshta mund të bëjmë pushimin tani
22 dhe të vazhdojmë pas pushimit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Dëshmitare, tani mund të largoheni nga salla e gjyqit, do të
25 bëjmë një pushim një gjysëm ore dhe do të rifillojmë më pas.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 46

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Mos diskutoni me askënd jashtë sallës së gjyqit, siç ju thashë
2 më herët, atë që është diskutuar dhe është thënë në sallë.

3 [Dëshmitaret përfundojnë dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
5 ndërpritet për 30 minuta. Kthehemi në orën 11.30.
6 Faleminderit.

7 --- Pauza fillon në orën 10.58

8 --- Seanca rifillon në orën 11.30

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
10 sillini dëshmitaret në sallë.

11 [Dëshmitaret vijojnë dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Prinsen
13 dhe Dr. Black, jemi gati që të vazhdojmë më tej. Ju lutem
14 dëgjojeni me vëmendje z. Laws.

15 Z. Laws, mund të vazhdoni.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

17 PY. Sikurse e thashë edhe përpara pushimit, do t'ju pyes tani
18 lidhur me rëndësinë e drejtësisë dhe njohjes apo pranimi të
19 asaj çfarë ka ndodhur. Për këtë arsye dua t'ju kujtoj për dy
20 pjesë për dy paragrafë në raport dhe pastaj do ju bëj pyetje
21 përkatëse.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Së pari do i kërkoja Sekretares që të
23 kalojmë tek raporti i IMMO-së që pamë përpara sesa të shkonim
24 për pushim. Të shohim konkretisht faqen 8 duke përdorur numrat
25 e faqeve brenda raportit, me fjalë të tjera është dokumenti në

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 47

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 faqen V00012 [Sipas përkthimit] në të djathtë. Faleminderit.

2 Do i lutesha Sekretares ta zmadhojë gjysmën e parë të faqes.

3 PY. Në raport flitet për studimet të kryera sa i takon

4 kohëzgjatjes së simptomave të PTSD-së. Do kaloj direkt në

5 fjalinë e fundit në këtë paragraf. Do ta lexoj për juve. Në të

6 thuhet që:

7 "Angazhimet në besimet ideologjike dhe kërkesa për

8 drejtësinë, gjithashtu dhe për përgjegjësinë për atë çfarë ka

9 ndodhur, janë pjesë e njohjes."

10 Atëherë, do të doja t'i referohesha edhe një herë

11 formulimit që "kërkesa për drejtësi dhe drejtësia dhe njohja

12 zyrtare e përgjegjësisë gjithashtu kanë ndikim mbi rimëkëmbjen

13 ose mbi marrjen e vetes së personave të prekur."

14 Nga ana tjetër do i kërkoj Sekretares që të kalojmë në

15 faqen 15.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Është faqja që përfundon me 19 në

17 fund, fillon me V.

18 PY. Është fjalia që është në krye të faqes. Fjalia është kjo:

19 "Për më tepër, çështje të shëndetit mendor përkeqësohen

20 nga stresi i vazhdueshëm social dhe ekonomik, së bashku me

21 mungesën e drejtësisë dhe mbështetjes institucionale."

22 Pyetja që kam për ju, së pari, Dr. Black, e kam për juve

23 pyetjen. A mund të na ndihmoni dhe të na shpjegoni se si

24 rëndësia e drejtësisë, mungesa e drejtësisë dhe njohja se

25 çfarë kanë pësuar personat mund të kenë ndikim mbi rimëkëmbjen

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 48

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 e tyre ose shërimin e tyre dhe cilat janë arsyet se pse
2 shëndeti mendor, pra, në vetvete bëhet më i rëndë si rezultat
3 i mungesës së drejtësisë ose i njohjes së asaj çfarë kanë
4 kaluar personat.

5 Atëherë, znj. Black, ju jeni e para, ju lutem, na thoni
6 çfarë na mendoni lidhur me këtë pyetje.

7 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Catherine Black. Nga
8 përvoja klinike do thoja se njëra prej mënyrave se si mungesa
9 e drejtësisë ose mbështetjes sociale ose institucionale mund
10 të ketë ndikim negativ ose mbi përkeqësimin e çështjeve që
11 kanë të bëjnë me shëndetin mendor, është përmes asaj që neve e
12 quajmë ndryshe si zhvlerësim ose mosvalidim, mosvlerësim i
13 asaj çfarë ka kaluar viktima. Pra, në qoftë se t'i nuk
14 vlerëson nuk njeh përvojat ose pjesën emocionale të dikujt kjo
15 mund të ketë një ndikim shumë negativ mbi shërimin nga trauma.

16 Ose një tjetër mënyrë se si mungesa e drejtësisë mund të
17 ketë ndikim mbi tema të shëndetit mendor, për shembull, në
18 qoftë se mungesa e drejtësisë mund të ketë ndikim mbi
19 kërcënimet në vazhdimësi, kjo mund të ketë ndikim mbi
20 personin, mbi shërimin. Pra, në qoftë se personi është objekt
21 i kërcënimeve të vazhdueshme, për shembull, në qoftë se dikush
22 është në një situatë të dhunës në familje mund ta trajtosh
23 situatën e dhunës në familje, megjithatë, në qoftë se personi
24 vazhdon që të jetë në situatë stresi të vazhdueshëm që mund të
25 jetë ose për shkak të dhunës në familje ose për shkaqe të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 49

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 tjera, atëherë kjo në vetvete mund të ketë ndikim mbi shërimin
2 nga problemet e shëndetit mendor.

3 Gjithashtu, nga përvoja klinike ne vëmë re se aktet e të
4 dëgjuarit, domethënë, vetëm veprimi i të dëgjuarit të dikujt
5 të shqetësimeve të veta, pra, përdoret si një prej trajtimeve
6 terapeutike që përdoret për refugjatët, pjesa më e madhe e të
7 cilëve janë objekt i keqtrajtimit ose, domethënë, një tjetër
8 terapi që përdoret është terapia e narrativës, së shpjegimit
9 të asaj çfarë i ka ndodhur atyre. Domethënë, kjo është
10 elementi terapeutik që përdoren, janë ato që nxirren nga
11 rrëfimi i personave që e kanë vajtur traumën. Pra, nuk është
12 një dëshmi si puna e dëshmimeve që dëgjoni ju këtu në Gjykatë,
13 por është një lloj përjetimi i thënë me fjalë i refugjatëve
14 ose personave të caktuar, dhe kjo në vetvete përdoret si
15 praktikë terapeutike.

16 PY. Pra, vetë akti ose veprimi që dikush të thotë me gojën e
17 vet se çfarë ka pësuar, çfarë ka vuajtur, në vetvete është
18 terapi, është akt terapeutik, apo jo?

19 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po. Mund të jetë, është një
20 prej elementëve të trajtimit të personit në fjalë.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Prinsen, dëshironi të shtoni diçka, apo jo?

23 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, nuk kam gjë për
24 të shtuar. Ajo çfarë tha kolegja është e saktë.

25 PY. Faleminderit.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 50

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Z. LAWS: [Përkthim] Në rregull. Tani do të kalojmë tek
2 një pyetje tjetër, pyetja e dytë që jepet në faqen 11 të
3 raportit ose në faqen 15 të raportit që fillon me V, në qoftë
4 se nuk e kam gabim.

5 PY. Pyetja ka të bëjë me viktimat e tërthorta. Do ta lexoj
6 pyetjen.

7 "2. A. Cilat janë pasojat tipike (dhe/ose të mundshme)
8 psikologjike (në afat të shkurtër dhe të gjatë) nga personat
9 që kanë vuajtur nga rrëmbimi, tortura dhe/ose nga zhdukja me
10 detyrim ose vrasja me detyrim e personave të tyre të dashur?

11 Dhe nën pikën B pyetja tjetër është kjo:

12 "B. Çfarë dihet lidhur me mekanizmat e përballjes në
13 raste të tilla?"

14 Sikur që ju jeni përgjigjur në disa faqe kësaj pyetje.
15 Nuk dua që ju të flisni në hollësi lidhur me këto dy pyetje,
16 gjithsesi do ju kërkoja që të jepni disa sqarime.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Kalojmë te faqja 12 e raportit ose me
18 numër V është faqja 16 e dokumentit që keni përpara. Le të
19 kalojmë në fund të faqes.

20 PY. Në nëntitullin "Vrasje", mund të lexohet si më poshtë:

21 "Vrasja e një personi të dashur mund të çojë në një
22 çrregullim të vazhdueshëm dhimbje në kuadrin afatgjatë."

23 Ju lutem na e shpjegoni çfarë keni dashur të thoni me
24 këtë, çfarë do të thotë "çrregullim i vazhdueshëm dhimbjeje".

25 Znj. Black, ju e para.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 51

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Catherine Black.

2 Çrregullimi i vazhdueshëm i dhimbjes ndodh kur dhimbja normale
3 ngec, pra, ose ndërpritet ose ngec, thjesht tek faza e
4 dhimbjes sepse, në fakt, ekzistojnë faza të ndryshme
5 dhimbjeje, ka ndryshim të dhimbjes dhe e quajmë çrregullim i
6 dhimbjes, një proces i cili, në fakt, është shumë më intens
7 sesa normalisht dhe që shtrihet në kohë dhe që është goxha më
8 ndërhyrës në funksionimin dhe jetën e dikujt sesa do të ishte
9 një situatë normale. Pra, në qoftë se kjo kohëzgjatja është më
10 e madhe dhe ndikimi është më i madh krahasimisht me atë çfarë
11 pritet nga normat e shoqërisë dhe kulturore atëherë kemi të
12 bëjmë me çrregullim të vazhdueshëm.

13 Pra, ka një dhimbje dhe një situatë të tillë ku dikush
14 mendon vetëm për këtë gjë, domethënë nuk mendon as për
15 ekzistencën e vet ose praninë e vet por duket sikur identiteti
16 i tyre është absolutisht i lidhur vetëm me fatkeqësinë që i ka
17 ndodhur atij personi, pra, dhe nuk ka shumë për t'u bërë, nuk
18 ka shumë gjë në jetë ai person. Në tekstin që sapo lexuat,
19 pra, gjithashtu, në pjesë të tekstit thuhet që, "në veçanti në
20 rast të humbjes traumatike", mund të ndodhë që të ekzistojë
21 një lloj përzierje e simptomave post-traumatike, pra, në qoftë
22 se në qoftë se humbja ka qenë traumatike, me fjalë të tjera,
23 në qoftë se ka qenë një humbje e dhunshme ose në qoftë se jemi
24 në situata të tilla të ngjashme, atëherë kemi një kombinim të
25 hidhërimit për humbjen me simptomat e stresit post-traumatik.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 52

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 PY. Ju thoni që simptomat e tilla janë shumë herë më të mëdha
2 në qoftë se personi që ka vdekur është person që është fëmija
3 i dikujt në qoftë se është partner ose partnerja a dikujt. A
4 është kështu?

5 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Po.

6 PY. Do i kërkoja ekspertës tjetër të përgjigjet në qoftë se
7 ka ndonjë gjë për shtuar.

8 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë
9 për të shtuar.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Le të vazhdojmë në faqen 17, të
11 shohim paragrafin me titullin "Zhdukja me detyrim ose me
12 forcë".

13 PY. Në këtë pjesë mund të shohim që ju përmendni protokollin
14 që ekziston në raste të tilla që është Protokolli i
15 Stambollit. Mbase do të ishte momenti i përshtatshëm që të na
16 shpjegoni se çfarë është Protokolli i Stambollit dhe si
17 përdoret, për çfarë arsyes përdoret Protokolli i Stambollit
18 nga persona që bëjnë vlerësim.

19 Znj. Prinsen, doni të filloni ju me përgjigjen e kësaj
20 pyetjeje?

21 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po. Protokolli i
22 Stambollit është një udhëzim i Kombeve të Bashkuara që njihen
23 në mbarë botën për dokumentin e torturës e trajtimit
24 çnjerëzor. Është një dokument i cili përmban udhëzime,
25 këshilla për profesionistët ligjorë, psikologjikë dhe të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 53

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 tjerë, se si t'i vijnë në ndihmë viktimave të torturës apo se
2 si të kryejnë ekzaminimet dhe si të bëjnë raportimet ose si të
3 bëjnë akt-ekspertizat e ndryshme. Domethënë është një dokument
4 i cili është mbështetur në faktet shkencore dhe mbështetur në
5 ekspertizën mjeko-ligjore ose forensike që ekziston sipas
6 fushës përkatëse.

7 PY. A është ky një instrument apo a është një dokument që ju
8 si ekzaminuese e IMMO përdorni vazhdimisht?

9 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, shërben si një
10 udhëzues për shqyrtimet ose analizat që bëjmë ne.

11 PY. Pas pak kohe ne do të shikojmë dy raportet që keni
12 përgatitur për një proces gjyqësor të mëparshëm. Dua t'ju pyes
13 për momentin në qoftë se ato dy raporte, akt-ekspertiza i keni
14 hartuar mbështetur në këtë dokument apo jo?

15 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

16 PY. Atëherë, fundi i citimit që ka të bëjë me Protokollin e
17 Stambollit thotë që "zhdukja me forcë shkakton vuajtje nga të
18 afërmit që arrijnë deri në pragun e torturës". A është e saktë
19 kjo?

20 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, është e saktë.

21 PY. Në paragrafin vijues, që e keni përpara në ekran tani,
22 diku nga mesi i paragrafit, është një fjali ku thuhet që:

23 "Kjo humbje, ky lloj, kjo lloj humbje, gjithashtu e
24 njohur si humbje e paqartë është e vështirë që të përpunohet
25 sepse nuk ka qartësi lidhur me atë çfarë ka ndodhur për

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 54

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 personin në fjalë ..."

2 Për të qenë të qartë, këtu e keni fjalën për zhdukjet me
3 forcë dhe pasojat e zhdukjes me forcë, apo jo. Dhe dua t'ju
4 pyes konkretisht për "humbjen e paqartë". Çfarë do të thotë
5 "humbje e paqartë". Mund të na e shpjegoni, znj. Prinsen?

6 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Nuk e kuptova qartë
7 pyetjen. Duhet të shpjegoj se çfarë është "humbja e paqartë".
8 PY. Po. Ju lutem na e shpjegoni çfarë do të thotë ky term.

9 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Kjo do të thotë që
10 ti ke humbur dikënd, por për shkak të faktit që bëhej fjalë
11 për një zhdukje me forcë, ju nuk e dini se çfarë i ka ndodhur
12 atij personi, nuk e dini në qoftë se ky person ka vdekur apo
13 dhe këtu qëndron paqartësia për këtë humbje. Domethënë nuk
14 është një humbje e vërtetë se nuk e dini sesi ka vdekur
15 ekzaktësisht dikënd -- dikush, por thjesht e dini që dikush
16 është zhdukur dhe nuk keni shumë informacion rreth vdekjes së
17 këtij personi.

18 PY. Ju vazhdoni në raport dhe thoni se:

19 "... është e vështirë për t'u përpunuar sepse nuk ka
20 qartësi lidhur me atë çfarë i ka ndodhur personit, çfarë do të
21 thotë që dhimbja dhe vuajtja vazhdon dhe personi, pra, që
22 vuan, është -- nuk është në gjendje që ta mbyllë këtë pjesë të
23 kapitullit të jetës së tij."

24 Apo jo?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, është shumë e

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 55

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 vështirë që të mbyllet dhimbja.

2 PY. Në rregull. Do vazhdojmë me pyetjen 3.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Për këtë do i kërkoj Sekretares që të
4 kalojmë në faqen V18. Kalojmë tek pyetja 3.

5 PY. Pyetja është:

6 "Cilat janë simptomat psikologjike të zakonshme tek
7 personat që vuajnë nga trauma në mungesë të ndërhyrjes
8 terapeutike?"

9 Edhe një herë nuk do ta lexoj të gjithë përmbajtjen e
10 përgjigjes nën këtë pikë, por thjesht dua që t'ju bëj disa
11 pyetje për ta sqaruar më mirë pozicionin tuaj.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Kalojmë tek paragrafi në fund. Le të
13 shohim paragrafin në fund të faqes --

14 PY. -- që ka të bëjë me një studim për pacientët të cilët
15 kanë PTSD për shkak të luftës dhe nuk janë trajtuar dhe ju
16 thoni që:

17 "Ka persona të shumtë të cilët nuk janë trajtuar për PTSD
18 pas luftës, dhe këta persona shfaqin simptoma dhe shumë vite
19 pasi ka përfunduar lufta."

20 Po ashtu thuhet që:

21 "Ka një nivel të lartë të PTSD dhe çrregullimeve të
22 humorit ndërmjet personave që nuk janë trajtuar ..."

23 Le të përqendrohemi te kjo pjesë tani. Këtu kemi të bëjmë
24 vetëm me konstatime që lidhen me luftën, apo jo? Sipas
25 mendimit tuaj, a zbatohet kjo në grupe më të mëdha të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 56

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 personave që vuajnë nga PTSD-ja, për shembull, persona të
2 cilët mund të kenë qenë të ndaluar, që janë torturuar, e të
3 tjerë, apo thjesht lidhen me personat që kanë përjetuar
4 situata lufte?

5 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Ju lutem, na e sqaroni dhe
6 një herë pyetjen.

7 PY. Atëherë, pyetja që kisha për ju ka të bëjë me paragrafin
8 në fund të faqes. Sipas këtij paragrafi, ju thoni që:

9 "Ka studime në vende të ndryshme të Ballkanit ... që 84
10 për qind e pacientëve të patrajtuar me PTSD për shkak të
11 luftës ende shfaqin simptoma vite pas lufte."

12 Pyetja ime ishte kjo: Ky është një konstatim i cili
13 lidhet vetëm me pacientët me PTSD për shkak të luftës apo mund
14 të shtrihet gjithashtu edhe për persona të tjerë që kanë
15 vuajti, për shembull, persona që janë mbajtur të ndaluar, që
16 janë keqtrajtuar, e të tjerë?

17 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Me aq sa më kujtohet mund
18 të konfirmoj që përqindja ose të dhënat këtu, domethënë,
19 thuhet 84 për qind të pacientëve të patrajtuar me PTSD, pra,
20 unë nga përvoja ime klinike dhe nga ajo çfarë di dhe ajo çfarë
21 përshkruhet në përgjithësi në literaturë, nuk mendoj se ka
22 ndonjë dallim mes pacientëve me stres post-traumatik për shkak
23 të luftës edhe viktimave të tjera ose pacientët që kanë
24 vuajtur për shkaqe të tjera që mund të jenë persona, për
25 shembull, që kanë vuajtur nga tortura ose nga persona që janë

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 57

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 mbajtur të ndaluar. Nuk shoh ndonjë dallim midis këtyre
2 llojeve të pacientëve. Pra, janë persona të cilët kanë vuajtur
3 nga traumatizime ose trauma të rënda, kështu që personalisht
4 nuk pres që të ketë ndonjë dallim midis kategorive të ndryshme
5 të pacientëve të tillë.

6 PY. Në rregull. Le të kalojmë tek fjalja e fundit:

7 "Trauma e pazgjedhur -- e pazgjidhur shkakton probleme si
8 fizike ashtu edhe të shëndetit mendor."

9 A mund të na e shpjegoni çfarë nënkuptohet me termin
10 "traumë e pazgjidhur".

11 Znj. Prinsen, do na e thoni ju?

12 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, "trauma e
13 pazgjidhur" është një traumë e cila nuk është trajtuar ose që
14 vazhdon ende dhe është pjesë e personit, ose për shembull, në
15 qoftë se dikush vuan akoma nga simptoma e stresit post-
16 traumatik, është akoma i traumatizuar, atëherë në këtë rast
17 kemi të bëjmë me traumë të pazgjidhur.

18 PY. Atëherë në këtë kontekst, pra, shënimi që keni dhënë në
19 paragrafin e parafundit që:

20 "Ideja që 'koha shëron të gjitha plagët' nuk është një
21 ide që mbështetet nga kërkimi."

22 Apo jo, është kështu, Dr. Black?

23 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Jo, nuk është -- nuk është
24 një deklaratë e përgjithshme që është gjithmonë e vërtetë, jo
25 si rregull i përgjithshëm koha i shëron të gjitha plagët.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 58

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Sikurse e kemi përshkruar dhe në raport simptomat e stresit
2 post-traumatik mund të zgjasin për vite e vite të tëra dhe
3 mbase do ishte mirë që të shtoja këtu se me kalimin e kohës
4 ato mund të shërohen, mund të ndryshojnë, por edhe mund të
5 trashëgohen. Domethënë, mund t'i kalohen edhe brezave të tjerë
6 më të rinj. Këtë e kemi shpjeguar dhe e kemi përshkruar
7 gjithashtu trauma që kalojnë nga një brez tek tjetri.
8 Domethënë, ka shumë kërkime që e mbështesin këtë tezë.
9 Domethënë, pra, në institucionin ku kam punuar unë ka
10 konstatuar që për viktimat e Holokaustit, për viktimat e
11 Luftës së Dytë Botërore dhe përderisa ne mund të bëjmë studime
12 tani dhe në breza të dytë dhe në breza të tjerë, studimet
13 tregojnë që trauma trashëgohet, në thonjëza, ose kalohet nga
14 një brez tek tjetri, domethënë, kalon nga prindërit te fëmijët
15 po madje edhe tek nipërit e mbesat. Kjo mendoj që shërben sa
16 për të ilustruar përgjigjen e pyetjes që më bëtë, apo jo?
17 PY. Po. Të kalojmë më tej. Do kalojmë me pyetjen 4, që jepet
18 në faqen 18 të raportit, ose në qoftë se do përdorim numrat në
19 raport është faqja që përfundon me 22 V22. Do shohim pyetjen
20 së pari, pastaj do mundohemi që të kuptojmë metodën që keni
21 përdorur. Pyetja është kjo?

22 "Bazuar në informacionin që i është dhënë imMO-së nga
23 Mbrojtësi i Viktimave, cilat janë simptomat dhe pasojat që
24 përjetojnë [viktimat] pjesëmarrëse në proces?"

25 Dhe me fjalë të tjera:

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 59

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 "Deri në çfarë mase këto simptoma përkojnë me pasojat,
2 simptomat dhe mekanizmat e përshkruar në përgjigje në pyetjet
3 1, 2, dhe 3"?

4 Domethënë që janë tre pyetje që unë bëra pak më herët.
5 Dua t'ju kërkoj që të na shpjegoni metodologjinë e përdorur.
6 Le të fillojmë me atë çfarë ju është dhënë.

7 Z. LAWS: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye do i kërkoja
8 Sekretares që paraqesë në ekran dokumentin V00000340 deri në
9 0000341. Të shohim të gjithë faqen nëse është e mundur.
10 Faleminderit.

11 PY. Ky është një dokument shoqërues i dorëzimit të materialit
12 të parë që kemi bërë, domethënë, nga ekipi i Mbrojtjes së
13 Viktimave për IMMO-n që mban datën 23 dhjetor 2024. A e njihni
14 këtë dokument si atë që unë sapo përshkrova, znj. Prinsen?

15 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

16 PY. Këtu jepet një listë e dokumenteve që juve ju është
17 dhënë, po ashtu është një dokument i cili mundohet që t'ju
18 ndihmojë lidhur me mënyrën sesi do të përpunoni informacionin.
19 Po ashtu jep udhëzime lidhur me kategoritë e ndryshme të
20 viktimave pjesëmarrëse në proces, sikurse mund ta shihni.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Dhe nëse do të kalojmë në fund të
22 faqes. Do i lutesha Sekretares të kalojmë drejt fundit të
23 faqes. Për sqarim, ky është dokument i cili nuk duhet
24 transmetuar për publikun. Të shohim dhe gjysmën e dytë të
25 faqes. Shumë faleminderit.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 60

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 PY. Pra, këtu mund të lexoni sqarimet e dhëna që viktimat të
2 cilat kanë qenë dëshmitarë dhe në qoftë se ato kanë qenë dhe
3 kanë dhënë dëshmi sipas rregullës 154, pra, do ju jepen
4 dëshmitë e tyre, pra, për këtë kategori dëshmitarësh ju është
5 dhënë informacion shtesë, domethënë, ajo çfarë quhet ndryshe
6 informacion shtesë për dëmin e pësuar.

7 Z. LAWS: [Përkthim] Kalojmë te faqja tjetër.

8 PY. Pra, kemi gjithashtu dhe kategorinë e veçantë të
9 viktimave që kanë dëshmitarë gjithashtu, por dëshmitë e të
10 cilëve janë paraqitur me shkrim dhe viktimat të cilët nuk janë
11 dëshmitarë në këtë lëndë gjyqësore, dhe së bashku me këtë
12 dokument juve ju është dhënë një dokument në Excel ku jepet
13 informacioni dhe dokumentet që ju janë dhënë lidhur me secilin
14 prej viktimave ku është treguar gjithashtu cili ka qenë rendi
15 dhe ku ju është shpjeguar në qoftë se viktimat përkatëse kanë
16 qenë viktimat të drejtpërdrejta apo të tërthorta.

17 A është kështu, znj. Prinsen.

18 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

19 PY. Në rregull.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Kalojmë te dokumenti tjetër. Është
21 dokumenti V000342.

22 PY. Është dokumenti që mban datën 14 shkurt 2025. Në këtë
23 datë ju keni informacion, atë çfarë ne e quajmë ndryshe
24 parashtrim i dytë dhe i tretë i materialit nga Mbrojtësi i
25 Viktimave. Është përsëri një dokument udhëzues për iMMO-n.

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 61

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 Ndërkohë, pra, shikoni parashtimet në të cilat IMMO mund të
2 shikojë situatën dhe se si kjo situatë ka pasur ndikim mbi
3 dëmtimin e viktimave dhe viktimat janë gjithsej 108.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Ndërkohë që në qoftë se do të kalojmë
5 te paragrafi 4, dua që të lexoj një pjesë tjetër të udhëzimeve
6 që ju janë dhënë:

7 "Dua të theksoj që nuk është bërë një përzgjedhje e
8 viktimave pjesëmarrëse nga ana jonë. Ne kemi dhënë gjithë
9 informacionet e viktimave pjesëmarrëse që kanë dhënë pëlqimin
10 e tyre për nxjerrjen e informacionit të tyre për IMMO-n dhe
11 lidhur me të cilët ne kemi mendimin që dëshmitë e tyre mund
12 t'ju japin juve disa hollësi sa i takon vuajtjes që ato kanë
13 pësuar."

14 Në pikën 5, jepen gjithashtu edhe arsyet e kategorive ose
15 personave të cilat nuk janë përfshirë.

16 Këto janë dokumente që ju i keni marrë si pjesë e paketës
17 së udhëzimeve që janë dhënë, apo jo, znj. Prinsen?

18 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

19 PY. Pra, ju keni pasur gjithsej dokumente për 108 viktima, që
20 variojnë nga dokumente nga dosje të mëdha, voluminoze - më
21 duket madje se një dosje kishte 600 faqe, kishte dhe dosje me
22 shumë pak faqe. A është kështu?

23 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

24 PY. A i konsideruat ju, a menduat se ishte praktike, ishte e
25 realizueshme të trajtonit të 108-ta rastet?

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 62

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Unë jam znj.

2 Prinsen. Jo, nuk ishte e mundur. Kërkonte shumë kohë. Nuk

3 kishim instrumentet për t'i shqyrtuar të 108-ta dosjet.

4 PY. Do ju pyes pak më vonë se si e keni bërë përzgjedhjen.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Por, përpara se të hiqet dokumenti, a

6 mund t'i japim një numër provizor, ju lutem, ku përfshihet dhe

7 letra me udhëzime dhe dokumentet që sapo pamë?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Përkthim] Mund t'i jepni numër provizor.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë,

11 dokumenti me ERN V0000338 deri në V0000342 do të marrë numrin

12 provizor V00034 dhe klasifikimi është konfidencial.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Mund të hiqet dokumenti

14 tashmë nga ekrani.

15 PY. Pra, pasi vendosët që nuk mund t'i shqyrtonit 108 dosje,

16 çfarë bëtë ju më pas?

17 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Vendosëm të

18 shikonim 50 dosje që është një sasi e konsiderueshme nga 108

19 dosjet që kishim marrë gjithsej.

20 PY. A mund të na shpjegoni si u përzgjodhën këto 50 dosje?

21 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Unë jam znj.

22 Prinsen. Unë kisha një shënim përgatitor ku shpjegohet se si

23 duhet të funksionojë përzgjedhja, besoj që të gjithë e marrin

24 këtë shënim. Dosjet apo viktimat, e thënë ndryshe, ose janë

25 përzgjedhur në formë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Pesë

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 63

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 dosje ishin dhe viktimat dhe të drejtpërdrejtë dhe të
2 tërthorta sepse kjo ishte një kategori unike. Kështu që
3 vendosëm, meqë ishte kaq unike kjo kategori, t'i shqyrtonim të
4 pesta dosjet e këtyre personave. Më pas pamë sa dosje ishin të
5 viktimave të drejtpërdrejtë dhe sa ishin viktima të tërthorta.

6 Për shkak të literaturës, hulumtimet tona bazohen në
7 literaturë, në bibliografi dhe ekzistojnë dy kategori për
8 viktimat e tërthorta, goftë në moshë madhore apo të mitur.
9 Pra, ne bëmë përzgjedhjen bazuar në vitin e lindjes në moshën
10 që kanë pasur në kohën e luftës, pra, a ka qenë viktimë e
11 tërthortë dhe a ka qenë në moshë madhore gjatë luftës, apo ka
12 qenë viktimë e tërthortë por fëmijë gjatë luftës. Pra, kishim
13 katër kategori, një ishin personat me moshë madhore të
14 tërthortë, persona në -- viktima të tërthorta për fëmijë, dhe
15 pastaj kishim dhe viktima që ishin dhe të drejtpërdrejtë dhe
16 të tërthorta.

17 Duhet -- mund ta -- a mund ta shoh dokumentin, a mund t'i
18 referohem pak dokumentit që kemi në ekran, nëse është e
19 mundur?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mundeni,
21 po jo ta lexoni, ë, thjesht për t'ju rifreskuar kujtesën.

22 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Përfundimisht
23 përzgjodhëm 20 viktima të drejtpërdrejta, dhe përzgjodhëm pesë
24 të dosje të viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Dhe
25 nga viktimat e tërthorta, zgjodhëm 15 persona me moshë madhore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Seancë e hapur)

Faqe 64

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

1 dhe 10 fëmijë. Procesi i përzgjedhjes ishte komplet rastësor
2 dhe të gjithë viktimat kishin një numër. Kështu që nuk i
